



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 459 Prot.

Tiranë, më 26.02.2026

V E N D I M

Nr. 46, datë 26 .02. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 198 Regj, datë 18.09.2025, paraqitur nga ankuesi z. A.M kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin (IEVP Peqin), me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “gjendjes familjare”, “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, z. A.M parashtron se : “*Diskriminimi ndaj meje A.M ka filluar që më datë 10.04.2025, nxirrem nga spitali IEVP Peqin, padrejtësisht dhe më dërgojnë në observim në dhomën nr.9 në IEP Peqin edhe pse vuaj nga 6 sëmundje. Këtë gjë e ka bërë grupi kriminal i diskriminimit që janë në IEVP Peqin, Shefi i Policisë, Komisar F. M.*”

Në vijim të ankesës, z. M. , pretendon se, diskriminohet për shkak të gjendjes familjare, si baba i 7 fëmijëve, 5 djem dhe 2 vajza dhe për këtë shkak ai pretendon se shihet me përçmim, poshtërim dhe përbuzje.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, ankuesi pretendon se shkak të 6 sëmundjeve që vuaj, i drejtohen me fjalët “*ti je psikopat, budalla, i çmendur, i mbaruar, je i sëmurë, i vobektë, etj...*”.

Në ankesën e tij z. M. shprehet se: “*po diskriminohem nga M. M, shefja e kujdesit të shërbimit shëndetësor në IEVP Peqin, N. G, doktoresha L. M në IEVP Peqin, farmacisti IEVP Peqin M. C, pra këta 5 persona që përfaqësojnë IEVP Peqin, më kanë nxjerrë nga spitali padrejtësisht Sëmundjet që vuaj, tronditje e rëndë psikike, diabet tipi 2, mëlçi e dhjamosur dhe e zmadhuar, veshka, nervi, nuk funksionon tek A.M , sipas institutit të mjekësisë ligjore IML me nr. vendimi 1483 datë*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

19.05.2019, dëmtim i përhershëm dhe i parikuperueshëm. Pagjumësi, stres, ankth, aritmi, tmerr, depresion, halucinacione çdo ditë dhe natë....

Unë A.M ka 5 muaj që jam në observim edhe pse nuk duhet të jem këtu pasi statusi im është i padënuar, i pafajshëm, i paraburgosur, qëndrimi im në observim 5 muaj është diskriminim total. Diskriminimi tjetër ndaj meje është se ka 9 muaj që jam në IEVP Peqin dhe emri im asnjëherë nuk figuron asnjëherë në aktivitetet sportive kalçeto. Diskriminimi tjetër ndaj meje është se ka 9 muaj që jam në IEVP Peqin dhe sipas kartelës time mjekësore, psikiatria ka shkruar që A.M të ndiqet çdo ditë nga psikologia e IEVP Peqin, por nuk jam ndjekur nga psikologia.”

Ankuesi parashtroi se në lidhje me këto problematika ka bërë rreth 15 shkresa, drejtuar Drejtorit të IEVP Peqin, Shefit të Policisë z. F.M, Shefit të Edukimit z. A.H, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Përfundimisht, ankuesi përkon nga Komisioneri, që:

- Të merren masa ndaj personave që e kanë nxjerrë me forcë nga Spitali IEVP Peqin.
- Të merren masa që të qëndrojnë në Sektorin e Paraburgimit, pasi statusi i tij është i padënuar, i pafajshëm, i paraburgosur.
- Të përfshihet në aktivitetet sportive (kalçeto)
- Të ndiqet çdo ditë nga psikologia e IEVP Peqin, siç është përcaktuar nga psikiatria.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar shprehimisht shkaqet e moshës dhe aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1317/2 prot datë 08.10.2025 dhe nr.1317/3 prot., datë 27.11.2025 , Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga IEVP Peqin në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr.5313 prot., datë 03.12.2025, IEVP Peqin ka kthyer përgjigje, duke parashtruar:

Në institucionin tonë ndodhet në cilësinë e të paraburgosurit shtetasi A.M , i biri i M. dhe i K., i datëlindjes 02.05.1984, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë. Arrestuar me datë 30.08.2022. Me shkurtim vendimi nr.1824 regj.them, datë 01.09.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- Vlerësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim A.M .
- Caktimin si masë sigurimi personal shtrënguese ndaj personit nën hetim A.M atë të “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i K.pr.Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, “ Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” të parashikuar nga neni 79/c, 278/1 të K.Penal.

Ardhur në institucionin tonë me datë 13.12.2024 nga IEVP “Jordan Misja”.

Mbi trajtimin e Sektorit të Sigurisë:

Që në momentin e ardhjes në institucionin tonë është akomoduar në ambientin e spitalit. Gjatë qëndrimit në ambientin e spitalit ka krijuar probleme me të burgosurit të cilët ishin të akomoduar në këtë ambient, për këtë arsye për të shmangur konfliktet në datë 10.4.2025 është akomoduar në ambientin e observimit, pasi ka qenë e pamundur të sistemohet në ambjentin e paraburgimit. Gjatë periudhës së qëndrimit në observim ka patur problem me një të dënuar të akomoduar në ambientet e observimit i cili është i pa sistemueshëm në asnjë sektor apo godinë, aktualisht ndodhet i akomoduar në Godinën e Paraburgimit.

Mbi trajtimin e Sektorit të Çështjeve Shoqërore:

Sektori i Çështjeve Shoqërore nëpërmjet punonjësve social dhe psikologut mban kontakt të përditshëm me të burgosurit duke ofruar asistencë psikologjike dhe këshillim individual, pasi në kartelën e tij klinike rezulton me çrregullim sjellje.

Pas ankesave të shumta është bërë lëvizja nga dhoma nr.9 në obsevimi dhe i dënuari është sistemuar në dhomën 6, sektori 5, Godina e paraburgimit me pëlqimin dhe dakortësinë e tij. Konfliktet e parashtruara nga i burgosuri A.M janë sheshuar dhe i burgosuri A.M merr pjesë në të gjitha aktivitetet e institucionit (aktivitete sportive).

Mbi trajtimin e Sektorit të Shëndetësisë:

Në lidhje me shërbimin shëndetësor, rezulton me numër Karte Klinike Shëndetësore nr.2095. Nga kartela e tij mjekësore rezulton me Dg:..... (Z....., S....., G....., F....., M.....).

Gjatë qëndrimit në institucion është ndjekur në vazhdimësi e në dinamikë, është konsultuar me mjekët e institucionit dhe me mjekë specialist si mjek endokrinolog e psikiatër, së fundmi më datë 12.3.2025 dhe është trajtuar sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë.

Më datë 6.5.2025, ky shtetas është konsultuar me mjekun e institucionit, ka rezultuar pa probleme akute, gjendje klinike shëndetsore e mirë, nga ekzaminimi parametrat brenda normës, respiracion vezikular bilateral, lëkura dhe mukozat të normalizuara, pulset periferike prezente, abdomen i palpueshëm, adolent dhe rekomandohet vazhdimësia e terapisë së caktuar nga mjekët specialistë.

Më datë 5.8.2025, ka kryer sërish konsultë me mjekun e institucionit, ku është rekomanduar kontroll psikiatri në bazë të protokollit mjekësor, ku çdo i sëmurë kronik kryen vizitë periodike 6 mujore ose 1 vjeçare tek mjeku specialist.

Më datë 14.8.2025, ka kryer konsultë me mjekun psikiatër, ku është rekomanduar vazhdimi i terapisë me Z..... 50 mg 1 tabletë në darkë, S..... 1 mg 1 tabletë në darkë dhe në rast ankthi ½ tabletë.

Më datë 8.10.2025 ka kryer vizitë mjekësore me mjekun e institucionit, ku ka referuar dhimbje shpatulle dhe është rekomanduar konsultë ortopedi dhe grafi në Spitalin Rajonal të Elbasanit.

Nga rishikimi i kartelës klinike, shtetasi në fjalë, merr rregullisht terapinë kronike medikamentoze të vendosur nga mjeku psikiatër. Aktualisht nga ana e ndihmës mjekësve, të cilët bëjnë të mundur shpërndarjen e terapisë kronike, nuk janë referuar ankesa akute shëndetësore.

Ky shtetas është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga stafi shëndetësor i institucionit dhe është trajtuar sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë. Ecuria e gjendjes së të burgosurit ndiqet në vazhdimësi nga stafi i shëndetësisë, në bashkëpunim me sektorët e tjerë për mbarëvajtjen sa më të mirë të tij në institucion.

3. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 1317/5 prot., datë 9.12.2025, ftoi në seancë dëgjimore më datë 15.12.2025, IEVP Peqin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB). IEVP Peqin dhe DPB iu kërkua që të depozitonin kopje të dokumentacionit provues në lidhje me informacionin e parashtruar pranë Komisionerit si dhe

informacion nëse ankuesi ka paraqitur ankesa në lidhje me çështjet e parashtruara në ankesë dhe si janë trajtuar këto ankesa.

Seanca dëgjimore e datës 15.12.2025 nuk u zhvillua pasi IEVP Peqin dhe DPB, njoftuan Komisionerin se ishin në pamundësi për të marrë pjesë.

IEVP Peqin dhe DPB depozituan nëpërmjet postës elektronike (*e-mail* datë 12.12.2025) informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga ana e Komisionerit.

Në kushtet kur informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar u depozitua, Komisioneri vlerësoi se nuk ishte e nevojshme caktimi i një seance tjetër dëgjimore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, ankuesi A.M , është i paraburgosur pranë IEVP Peqin, bazuar në shkurtim vendimin nr.1824 regj.them. datë 1.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin gjykata ka vendosur caktimin si masë sigurimi personal shtrënguese ndaj personit nën hetim A.M atë të “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” të parashikuar nga neni 79/c, 278/1 të K.Penal.

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se ankuesi është arrestuar në datën 30.8.2022. Ankuesi është akomoduar në IEVP Peqin në datën 13.12.2024 nga IEVP “Jordan Misja”. Në momentin e ardhjes në këtë institucion ai është akomoduar në ambientin e spitalit. Gjatë qëndrimit në ambientin e spitalit rezulton se janë krijuar probleme me të burgosur të tjerë të cilët ishin akomoduar në të njëjtin ambient. Për të shmangur konfliktet, në datën 10.4.2025 ankuesi është akomoduar në ambientin e observimit, dhoma 9.

Nga aktet e administruara rezulton se fillimisht ankuesi nuk ka shfaqur problematika dhe ka qenë dakort me sistemimin e tij në observim, fakt ky që rezulton nga një kërkesë që ai ka depozituar në datën 14.4.2025. Gjatë periudhës së qëndrimit në observim, rezulton që ankuesi ka patur probleme me të dënuar të tjerë të ndodhur në observim.

Rezulton se, në datën 22.9.2025, ankuesi është larguar nga observimi dhe është bërë i mundur sistemimi i tij në sektorin 5, kati 1, godina A, paraburgim. Nga kërkesë ankesat e paraqitura nga ankuesi pranë IEVP Peqin, rezulton se transferimi i ankuesit nga observimi për në një ambient tjetër ka qenë i kushtëzuar me dhënien e pëlqimit nga ana e ankuesit, pëlqim që rezulton që të jetë dhënë nga ana e tij në momentin që është sistemuar në datën 22.9.2025 në godinën e paraburgimit.

Referuar kërkesë/ankesave të shumta që ankuesi ka paraqitur gjatë kohës që ka qenë i akomoduar në spital dhe më pas në observim, në mënyrë të përsëritur ankuesi ka kërkuar që të marrë pjesë në aktivitete sportive që zhvillohen në IEVP. Nga verifikimi i kërkesë/ankesave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, nga ana e IEVP Peqin ankuesi është informuar se nuk është e mundur përfshirja e tij, sepse gjatë kohës së qëndrimit të tij në spital personat e tjerë të akomoduar për shkak të gjendjes shëndetësore nuk kanë shprehur dëshirën për të marrë pjesë në aktivitet sportiv, ndërsa akomodimi në observim nuk i mundësonte ankuesit të përfshihej në aktivitete sportive. Për të marrë pjesë në aktivitete sportive ankuesi duhej të bashkëpunonte për tu sistemuar në sektorin e paraburgimit.

Nga aktet e administruara rezultoi se, pas sistemimit të ankuesit në godinën e paraburgimit, ai është përfshirë në disa aktivitete sportive dhe edukativo-fetare, si dhe kurs të formimit profesional.

Konkretisht, ankuesi ka marrë pjesë në aktivitete sportive kalçeto në datat 4.11.2025, 7.10.2025, 13.10.2025, 21.10.2025, 21.11.2025, 29.10.2025, 3.12.2025, 12.12.2025.

Ankuesi ka qenë i përfshirë në listën e pjesëmarrësve në aktivitetin edukativo-fetar, i cili organizohet në bashkëpunim me Komunitetin Musliman Shqiptar, çdo ditë të premte të muajit dhejtor 2025, rituali i faljes së “Ditës së Premte”, me pjesëmarrjen e të paraburgosurve.

Ankuesi gjithashtu është përfshirë në listën e personave që do të ndjekin kursin profesional “Riparime Elektroshtëpiake” në regjimin e brendshëm, zhvilluar në bashkëpunimin me Drejtorinë e Formimit Profesional Elbasan.

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga IEVP Peqin, rezultoi se ankuesi rezultoi me diagnozat

Bazuar në informacionin e administruar rezultoi se, ankuesi në vazhdimësi është konsultuar me mjekët e institucionit dhe me mjekë specialist (e..... dhe p.....) në lidhje me shqetësimet shëndetësore që ka shfaqur dhe ankuar dhe konkretisht:

- Më datë 12.3.2025 është konsultuar me mjekë specialistë (e..... dhe p.....) dhe është trajtuar sipas rekomandimeve të tyre (me medikamentet Z....., S....., G....., F....., M.....).
- Më datë 6.5.2025, pas kontrollit mjekësor, është konstatuar në gjendje të mirë shëndetësore, pa probleme akute, me parametra brenda normës dhe është rekomanduar vazhdimësia e terapisë.
- Më datë 5.8.2025, është rekomanduar kontroll periodik psikiatrik.
- Më datë 14.8.2025, është kryer konsultë psikiatrike, ku është rekomanduar vijimi i terapisë me Z..... 50 mg (1 tabletë në darkë) dhe S..... 1 mg (1 tabletë në darkë dhe në rast ankthi ½ tabletë)
- Më datë 8.10.2025 ka kryer vizitë mjekësore me mjekun e institucionit, ku ka referuar dhimbje shpatulle dhe është rekomanduar konsultë ortopedike dhe grafi në Spitalin Rajonal të Elbasanit.

IEVP Peqin informon se, nga rishikimi i kartelës klinike, ankuesi merr rregullisht terapinë kronike medikamentoze të vendosur nga mjeku psikiatër dhe nuk janë evidentuar ankesa akute shëndetësore nga ana e stafit mjekësor.

Bazuar në informacionin dhe provat e administruara, kërkesë/ankesat që ankuesi ka paraqitur në IEVP Peqin nuk konstatohet se ndaj ankuesit ka komunikim të papërshtatshëm në lidhje me përdorimin e termave “*ti je psikopat, budalla, i çmendur, i mbaruar, je i sëmurë, i vobektë*” apo që ai të ekspozohet ndaj një trajtimi përcmues, poshtërues dhe përbuzës, për shkak të gjendjes familjare, si baba i 7 fëmijëve.

Rezulton se ankuesi ka ushtruar të drejtën e tij për të paraqitur ankesa pranë IEVP Peqin dhe DPB, por edhe institucioneve të tjera si Ministria e Drejtësisë dhe Avokati i Popullit.

Duke mbajtur në konsideratë ekspertizën që Avokati i Popullit ka në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut të privuar nga liria në sistemin penitenciar, me shkresën nr.330, datë 10.2.2025, Komisioneri iu drejtua Avokatit të Popullit, për të administruar konstatimet dhe vlerësimet që janë bërë nga ana e tij, si institucion i specializuar në këtë fushë gjatë trajtimit të ankesës së paraqitur nga ankuesi. Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga Avokati i Popullit me shkresën nr. K 2/A8-5 prot., datë 17.2.2026, për problematikën objekt i ankesës, nuk rezulton që të jenë konstatuar nga ky institucion shkelje të të drejtave ndaj ankuesit.

Të drejtat dhe trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, organizimi i sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente, rregullohen nga ligji nr. 81/2020 “*Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve*”.

Respektimi i të drejtave të njeriut, përfshi trajtimin pa diskriminim, përbën një nga parimet themelore të këtij ligji, sanksionuar në nenin 5 të tij, ku parashikohet: *1. Të burgosurit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues. 2. Të burgosurit trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.*”

Ligji nr. 81/2020 “*Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve*”, në nenin 5, pika 5, garanton trajtim i barabartë, pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Trajtimi i tyre duhet të kryhet sipas të njëjtave standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Nenet 41 dhe 42, të këtij ligji garantojnë që personat që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të gëzojnë të njëjtin shërbim të kujdesit shëndetësor që zbatohet për shoqërinë në përgjithësi dhe garantohet dhe që shërbimi i kujdesit shëndetësor t’i garantohet çdo të burgosuri dhe të paraburgosuri pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi.

Sa më sipër rezulton se, pas paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi pretendimet e paraqitura nga ankuesi kanë marrë zgjidhje. Rezulton se ankuesi që prej datës 22.9.2025 është larguar nga observimi dhe është sistemuar në godinën e paraburgimit në momentin që ka dhënë pëlqimin e tij. Gjithashtu rezulton se ankuesi është përfshirë në një sërë aktivitete sportive, edukativo-fetare dhe kurs profesional. Mospërfshirja e ankuesit në aktivitete sportive (kalçeto) rezulton që të ketë patur arsye objektive që e kanë pamundësuar pjesëmarrjen e tij dhe nuk u identifikuan veprime ose mosveprime nga ana e IEVP Peqin që e kanë penguar ankuesin të marrë pjesë në këto aktivitete Sipas informacionit të administruar, ankuesi është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga stafi shëndetësor i IEVP Peqin dhe mjekët specialist dhe është trajtuar sipas rekomandimeve të tyre.

Për sa më lart, përfundimisht Komisioneri vlerëson se, ankuesi A.M , nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e IEVP Peqin. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit A.M nga ana e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: “gjendja familjare”, “gjendja shëndetësore”, “çdo shkak tjetër”
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim